

UDHËZIM
Nr. 232, datë 14.1.2016

MBI NDRYSHIMIN E PRONËSISË SË MJETEVE RRUGORE

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikave 5 dhe 6, të planit të masave kundër informalitetit në fushën e transportit rrugor miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 806, datë 30.9.2015, ministri i Drejtësisë, ministri i Transportit dhe Infrastrukturës dhe ministri i Punëve të Brendshme,

UDHËZOJNË:

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzimi është të krijojë kuadrin e nevojshëm normativ për përcaktimin e procedurave, kompetencave, kriterëve dhe dokumentacionit për ndryshimin e pronësisë së mjeteve rrugore dhe përditësimin e lejes së qarkullimit të tyre, në mënyrë që të garantohet evidentimi i saktë i pronësisë mbi këto mjete.

Neni 2
Përkufizime

Për efekt të këtij udhëzimi, termat e mëposhtëm do të kenë këto kuptime:

“DPSH”, Drejtoria e Policisë së Shtetit.

“DPSHTRR”, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

“Importues i mjetit”, personi fizik ose juridik, gjeneralitetet e të cilit evidentohen në dokumentin e zhdoganimit dhe që posedon automjetin e ri ose të përdorur i cili hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë.

“Kontratë” veprimi juridik, me anë të të cilit palët krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike, brenda kufijve të vendosur nga legjislacioni në fuqi.

“Mjet rrugor”, sipas përkufizimit të nenit 54 të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar.

“Mënyrat e fitimit të pronësisë”, të gjitha mënyrat e fitimit të pronësisë përcaktuar në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar.

“Noter”, çdo subjekt i cili plotëson kushtet sipas nenit 2 të ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994, “Për noterinë”, i ndryshuar.

“Pronar i mjetit rrugor”, personi fizik ose juridik, që vërteton gëzimin dhe disponimin lirisht të automjetit, të lejes së qarkullimit dhe certifikatës së pronësisë që lëshon DPSHTRR-ja për një mjet të regjistruar.

Neni 3
Dokumentacioni që dorëzohet për mjet të regjistruar në DPSHTRR

Palët e interesuara për të nënshkruar një kontratë për kalim pronësie të mjetit, përpara noterit duhet të paraqesin:

1. Leje qarkullimi, e lëshuar nga DPSHTRR-ja në emër të pronarit aktual, në cilësinë e shitësit.
2. Certifikatë pronësie, e lëshuar nga DPSHTRR-ja në emër të pronarit aktual, në cilësinë e shitësit.
3. Dokument identifikimi ose prokurën e lëshuar nga palët kontraktuese së bashku me dokumentin e identifikimit të përfqësuesit.

Neni 4

Dokumentacioni që dorëzohet për mjet të paregjistruar në DPSHTRR

Palët e interesuara për të nënshkruar një kontratë për kalim pronësie të mjetit të paregjistruar në DPSHTRR, përpara noterit duhet të paraqesin:

1. Dokumentin e origjinës së mjetit me treguesit teknikë;
2. Dokumentin e fitimit të pronësisë në rast se subjekti që paraqet dokumentet përpara noterit nuk rezulton pronar i mjetit në dokumentin e përcaktuar në pikën 1;
3. Dokument identifikimi ose prokurën e lëshuar nga palët kontraktuese së bashku me dokumentin e identifikimit të përfaqësuesit.

Neni 5

Noteri dhe zyrat materiale

Pas dorëzimit të dokumentacionit të kërkuar në nenin 3 ose nenin 4, noteri:

- a) Verifikon gjeneralitetet e palëve. Fotokopjet e kartave të identitetit i bashkëngjit me kontratën me adresa të sakta sipas rregullave të përcaktuara nga aktet e brendshme të rregullimit të veprimtarisë së noterëve.
- b) Verifikon numrin e identifikimit të mjetit në bazën e të dhënave aktive të ruajtura në Regjistrin e Barrëve Siguruese. Nëse mjeti rezulton i lirë nga baza e të dhënave të Regjistrit të Barrëve Siguruese, nënshkruan kontratën dhe i bashkëngjit konfirmimin përkatës. Nëse mjeti rezulton me detyrim nga baza e të dhënave të Regjistrit të Barrëve Siguruese, njofton palët duke iu vënë në dispozicion edhe konfirmimin zyrtar të detyrimit përkatës.
- c) Verifikon numrin e identifikimit të mjetit në bazën e të dhënave të DPSHTRR-së nëse dosja e mjetit është e bllokuar për arsye të ndryshme financiare dhe ligjore. Nëse dosja e mjetit është e lirë nënshkruan kontratën. Nëse është e bllokuar njofton subjektet e interesuara bashkë me arsyen përkatëse.
- d) Dërgon në formë elektronike për njoftim kontratën e nënshkruar dhe të vulosur në adresat elektronike të DPSHTRR-së.
- e) Njofton subjektin blerës për përgjegjësitë dhe penalitetet financiare të parashikuara në nenin 93, të ligjit nr. 8378, datë 22.4.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në rast të tejkalimit të afatit prej 10 ditësh nga data e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes deri në kryerjen e shërbimit në sportelet e DPSHTRR-së për përditësimin e lejes së qarkullimit me ndryshimin përkatës.

Neni 6

Kontrata materiale

Në formulimin e një kontrate materiale, duhet të konsiderohen për përmbajtje dhe përshkrim këto elemente:

1. Gjeneralitetet e plota të personave në cilësinë e shitësit dhe blerësit;
2. Adresat e vendbanimit të personave në cilësinë e shitësit dhe blerësit;
3. Të dhënat teknike të mjetit, si: targa, numri i identifikimit, lloji, marka, emërtimi tregtar, ngjyra;
4. Numri i serisë së lejes së qarkullimit dhe certifikatës së pronësisë vetëm kur mjeti është i regjistruar në DPSHTRR;
5. Përgjegjësitë ligjore dhe administrative;
6. Detyrimet financiare ndaj DPSHTRR-së;
7. Detyrimin që në një afat prej 10 ditësh nga data e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes të evidentohet personi në cilësinë e blerësit si pronar i mjetit në lejen e qarkullimit, për të shmangur penalizimin nga organet e ngarkuara me ligj.

Neni 7

Përgjegjësitë e DPSHTRR-së

Miraton të drejtën për hyrje të çdo noteri ose zyre noteriale sipas kërkesave të këtyre të fundit, pasi të kenë konfirmuar se pranojnë dhe janë dakord me të gjitha kushtet dhe kriteret e përdorimit të sistemit, në bazën e të dhënave të saj me të drejtë *view* për t'u konsultuar me mjetet nëse janë të bllokuara dhe arsyen e bllokimit.

Neni 8

Përgjegjësitë e DPSH-së

Në rast se DPSH-ja konstaton në qarkullim mjete për të cilat nuk është respektuar procedura e parashikuar në nenin 93 të Kodit Rrugor, pas verifikimeve me DPSHTRR-në për shitblerjen e tyre, merr masa për bllokimin e tyre nga qarkullimi. Këtyre mjeteve u tërhiqet leja e qarkullimit dhe i dërgohet zyrtarisht DPSHTRR-së, e cila merr masa për rinovimin e saj, me paraqitjen e zotëruesit në zyrat e DPSHTRR-së.

Neni 9

Të tjera

Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen DPSHTRR-ja, Dhoma Kombëtare e Noterëve dhe DPSH-ja.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS

Edmond Haxhinasto

MINISTRI I DREJTËSISË

Ylli Manjani

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME

Saimir Tahiri